

# PHI LAN THR OPY

*edicioni 3*

*hapësira e dedikuar*

*për* FILANTROPINË

#philanthropy

— kontakt :   



Rockefeller  
Brothers Fund

Philanthropy for an Interdependent World

©PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

TIRANË, SHQIPËRI

Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Fondit Rockefeller Brothers. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondit Rockefeller Brothers.

PHI  
LAN  
THR  
OPY

*hapësira e dedikuar*

*për* FILANTROPINË

# Në këtë edicion



**5**

Rreth revistës

**8**

Të dhëna rreth  
aktivitetit filantropik

janar - dhjetor 2021

**19**

Iniciativat e para në  
Platformën

Smile.al

**23**

Java e Filantropisë  
2021

8-12 nëntor 2021



**30**  
Fondacione  
Komunitare

**36**  
Fushata në ndihmë të  
personave në nevojë

**40**  
Zhvillime në Evropë

***Ju ftojmë në edicionin e tretë të revistës  
Philanthropy!***

Në këtë edicion, ju do të njiheni me nismat e shumta mbi promovimin dhe zhvillimin e filantropisë në Shqipëri të ndërmarra gjatë muajve korrik - dhjetor 2021. Një fokus të veçantë zënë të dhënat dhe faktet nga **monitorimi vjetor i aktivitetit filantropik**, të cilat ofrojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të panoramës filantropike në vend.

Gjatë vitit 2021, Fondacioni Credins në bashkëpunim me Partnerët Shqipëri, Grand Thornton Albania dhe Fondacioni Vodafone Albania shpallën **platformën e parë crowdfunding në Shqipëri [Smile.al](https://smile.al)**. Platforma Smile.al, mundëson mbledhjen e fondeve nga dhurues nga e gjithë bota mbi iniciativat lokale të prezantuara duke i dhënë mundësinë gjithkujt të kontribuojë jo vetëm financiarisht por edhe vullnetarisht për realizimin e tyre. Gjatë këtij viti, u shpallë 5 iniciativat e para në fushat e mirëqenies sociale dhe solidaritetit, arsimit dhe trajnimit, mjedisit, inovacionit dhe veprimtarisë sportive.

R  
r  
e  
t  
h  
e  
n  
s  
h



Gjatë muajit nëntor 2021 u organizua për të dytin vit radhazi **“Java e Filantropisë 2021”**, me një seri aktivitesh për të rritur ndërgjegjësimin, aktivizmin, promovimin, dhe debatin publik, veçanërisht të të rinjve, mbi çështje të aktivitetit filantropik në vend.

Në këtë kohë pandemie, **Fondacionet Komunitare** janë struktura mjaft të rëndësishme për të adresuar nevojat e shumta të komuniteteve të cilave u shërbejnë. Duke qenë një strukturë që po prezantohet rishtazi në sektorin jofitimprurës, gjatë muajve nëntor – dhjetor janë organizuar takime me grupe informale dhe organizata të shoqërisë civile, të cilët kanë shprehur vullnetin e tyre për të operuar si të tilla. Diskutimet konsistuan në identifikimin e nevojave, rritjen e kapaciteteve dhe ofrimin e asistencës në këtë drejtim.

Një zhvillim mjaft i rëndësishëm i fundvitit 2021, është krijimi i **Shoqatës Filantropike Evropiane (Philea)**. E krijuar nga bashkimi i “European Foundation Centre” dhe “Donors and Foundations Networks in Europe”, “Philea” synon të krijojë një ekosistem të larmishëm dhe gjithëpërfshirës fondacionesh, organizatash dhe rrjetesh filantropike në mbi 30 vende që kanë këtë vizion e qëllim.

Nëse keni komente mbi artikujt e këtij edicioni apo jeni të interesuar për të qenë në edicionin e radhës, ju lutem shkruani tek [kkeruti@partnersalbania.org](mailto:kkeruti@partnersalbania.org)

*Lexim të këndshëm!*

OPEN





T Ë D H Ë N A  
R R E T H  
A K T I V I T E T I T  
F I L A N T R O P I K


J A N A R - D H J E T O R 2 0 2 1

Të dhënat e mëposhtme pasqyrojnë aktivitetin filantropik në Shqipëri gjatë vitit 2021, të prezantuara në mënyrë të sintetizuar nga Partnerët Shqipëri, bazuar në monitorimin ditor dhe raportimin e rregullt mujor. Metodologjia e përdorur është bazuar në të dhëna të mbledhura nga hulumtimi ditor i mediave, përfshi ato sociale si dhe nga institucionet publike dhe jo-publike gjatë periudhës **janar - dhjetor 2021**.

Raporti analizon sektorët dhe çështjet kryesore që janë mbështetur, natyrën dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik si dhe natyrën e dhuruesve dhe përfituesve.

Nëpërmjet këtij monitorimi, Partnerët Shqipëri synon të rrisë vetëdijen publike mbi aktivitetin filantropik dhe të informojë të gjithë aktorët e përfshirë dhe të interesuar mbi impaktin dhe vlerën sociale të tij.


## Numri i dhurimeve




- Monetare (87.74%)
- Mallra / Produkte (8.81%)
- Shërbime (2.25%)
- Punë vullnetare (0.86%)
- Miks (0.35%)

## Vlera sipas natyrës së dhurimit në Lekë


Mijë Lekë



Dhurime në grup



Dhurime individuale



Forma e dhurimit




Evente  
65

579


Dhurime të drejtpërdrejta  
239

Fushata për ngritjen e fondeve  
275


Dhurime në grup




Dhurime individuale



Dhurime në grup



Dhurime individuale




# Dhuresit sipas Formës së dhurimit


- Individë
- Biznes
- OJF
- Grup dhuruesish
- E panjohur
- Institucion publik
- Institucion ndërkombëtar
- Komunitet fetar
- Miks



- Grup dhuruesish
- Biznes
- Miks
- Individë
- OJF
- Institucion publik
- Komunitet fetar
- Institucion ndërkombëtar
- E panjohur



- Biznes
- Grup dhuruesish
- OJF
- Individë
- Miks
- Institucion publik



\*Dhuresit llogariten vetëm një herë, pavarësisht nga numri i dhurimeve të kryera në secilën prej kategorive të "Formës së dhurimit".

## Fushata për ngritjen e fondeve

95 Thirrje për Dhurim

8 Fushata përmes medias sociale

13 Fushata përmes medias vizive

7 Fushata përmes platformës Facebook për Impaktin Social\*

89 Fushata përmes platformave Crowdfunding

49 Mega Fushata


14 Fushata përmes medias sociale & platformave Crowdfunding

## Evente

65 Evente live


\*Platforma e dedikuar e Facebook për ngritje fondesh për kauza sociale.

## Numri total i dhuruesve\*



\*Në kuadër të kësaj analize, dhuruesit llogariten vetëm një herë, pavarësisht nga numri i dhurimeve të kryera gjatë procesit të monitorimit.

## Vlera sipas natyrës së dhuruesit



## 3 DHURUESIT KRYESOR sipas numrit të dhurimeve

- #1 Credins Bank
- #2 Fondacioni "Shpresë për Botën"
- #3 Banka Amerikane e Investimeve

## 3 DHURUESIT KRYESOR sipas vlerës së dhurimeve


**#1 Grup dhuruesish 26,128,548 Lekë**  
 Fushatë crowdfunding "Të Shpëtojmë Jetë Shqiptarësh!" për të ndihmuar personat që përballen me probleme të ndryshme shëndetësore në Shqipëri.

**#2 Grup dhuruesish 17,572,088 Lekë**  
 Fushatë crowdfunding "Të shpëtojmë jetët e Elisjanos dhe Omerit!" për vogëlushët të cilët janë përballur me probleme të rënda shëndetësore.


**#3 Grup dhuruesish 14,491,200 Lekë**  
 Fushatë crowdfunding "Të shpëtojmë jetën e Aurelit!" për 12 vjeçarit në luftën e tij kundër leuçemisë.

# Përfituesit Përfundimtar


- Fëmijë dhe të Rinjtë - Pa përkujdesje prindërore (22.63%)
- Fëmijë dhe të Rinjtë - Me aftësi të kufizuar (19.17%)
- Fëmijë dhe të Rinjtë - Vështirësi ekonomike (3.63%)
- Fëmijë dhe të Rinjtë - Të pastrehë (0.35%)
- Fëmijë dhe të Rinjtë - Zonë specifike (5.87%)
- Publik i gjerë - Zonë specifike (9.5%)
- Publik i gjerë - Me aftësi të kufizuara (4.32%)
- Publik i gjerë - Vështirësi ekonomike (17.96%)
- Publik i gjerë - Komunitetet minoritare (0.52%)
- Publik i gjerë - Komunitetet fetare (0.35%)
- Publik i gjerë - Sëmundje terminale (0.17%)
- Të Rritur - Me aftësi të kufizuar (2.59%)
- Të Rritur - Prindër të vetëm (0.86%)
- Të Rritur - Të moshuar (8.12%)
- Të Rritur - Të pastrehë (0.17%)
- Gra dhe Fëmijë - Viktima të dhunës dhe trafikimit (1.55%)
- Mbrojtja e kafshëve (0.69%)
- Miks (1.21%)
- Tjetër (0.35%)




## Shpërndarja Gjeografike e Përfituesve




## Shpërndarja Gjeografike e Dhuruesve







Diaspora 1.90%

Shtetas të huaj 2.42%






## Qëllimi i dhurimit



## Fjalorth

### Kanalet e dhurimit



**Dhurim i drejtpërdrejtë** - Dhurimi që kryhet direkt nga dhuruesi tek përfituesi

**Fushata për ngritjen e fondeve** - Mbledhje e fondeve që ndodh gjatë një periudhe të caktuar kohe për një kauzë të caktuar sociale

**Evente** - Është një ngjarje që organizohet në kuadër të mbledhjes së fondeve për një kauzë të caktuar

**Zbutja e Varfërisë** - Dhurimet që janë kryer për zbutjen e varfërisë për individë apo familje që jetojnë në vështirësi ekonomike apo të prekur nga fatkeqësitë e mëparshme natyrore

**Dhurime Sezonale** - Dhurime që kryhen gjatë sezonit të festave

**Publik i Gjerë** - Grupe njerëzish apo individë, të cilët janë ndihmuar nëpërmjet ndihmave ekonomike apo materiale në raste të fatkeqësive natyrore, apo vështirësive të jetesës

**Grup dhuruesish** - Grupe të mëdha ose të vogla individësh që dhurojnë

**Miks** - Dhurime të cilat kombinohen nga më shumë se një kategori / qytet

**NVM** - Ndërmarrje të vogla dhe të mesme

**Platforma Crowdfunding (Individë apo familje)** - dhurimet që kanalizohen përmes platformave online crowdfunding, të krijuara nga individë apo familje

**Platforma Crowdfunding (OJF)** - dhurimet që kanalizohen përmes platformave online crowdfunding, të krijuara nga OJF-të

**Institucione Private** - Biznese

smile.al



**I N I C I A T I V A T  
E P A R A  
N Ë  
P L A T F O R M Ë N**

**W W W . S M I L E . A L**

Smile.al është platforma e parë crowdfunding e krijuar në Shqipëri për mbledhjen e fondeve online. Ajo u shpall në maj të vitit 2021 si një nismë që synon zbatimin dhe promovimin e iniciativave novatore në vend përmes mbështetjes dhe mobilizimit të burimeve nga donatorët individë dhe institucional, me transparencë e përgjegjësi.


Në thirrjen e parë Fondacioni Credins shpalli 5 iniciativa në fushat e mirëqenies sociale dhe solidaritetit, arsimit dhe trajnimit, mjedisit, inovacionit dhe veprimtarisë sportive. Platforma Smile.al, mundëson mbledhjen e fondeve nga dhurues nga e gjithë bota mbi iniciativat lokale të prezantuara duke i dhënë mundësinë gjithkujt të kontribuojë jo vetëm financiarisht por edhe vullnetarisht për realizimin e tyre.

# INICIATIVAT



## Serë për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara intelektuale

Projekti i serës do të prekë drejtpërdrejt 127 fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara intelektuale midis moshës 6-18 vjeç të cilët studiojnë në shkollën speciale “Luigj Gurakuqi” në Tiranë. Qëllimi kryesor i projektit është të krijojë një mjedis miqësor mësimor për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara intelektuale dhe përveç kultivimit të bimëve, ai gjithashtu do t’i ndihmojë ata të rrisin aftësitë për jetën dhe tregun e punës. Qëllimi ynë nuk është thjesht ndërtimi i një sere, por edhe fuqizimi i fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara intelektuale, rritja e mirëqenies së tyre mendore. Për të marrë më shumë informacion dhe dhuruar shiko [këtu](#)



## Projekti NE'MO

Projekti NE'MO ideuar për t’u ofruar shërbim personave që kanë kafshë shtëpiake. Qëllimi është ofrimi i kujdesit për kafshët shtëpiake, kur pronarët kanë impenjimet e tyre. NE'MO është dizenuar të jetë aplikacion online, si edhe fizikisht si pikë e kontaktit të ofruesit dhe marrësit e shërbimit. Në këtë aplikacion pronarët e kafshëve do të kenë mundësinë të përzgjedhin dhe të rezervojnë shërbimin e dëshiruar prej tyre në çdo kohë. Ndërsa të interesuarit për t’u kujdesur për kafshët do të kenë mundësinë të aplikojnë ndërmjet aplikacionit dhe të kontrollojnë kërkesat e marra për shërbimin e tyre. Për të marrë më shumë informacion dhe dhuruar shiko [këtu](#)



## Edukimi për të Ardhmen

Ndërprerja e shërbimeve arsimore për shkak të situatës së krijuar prej Covid-19, ka krijuar një boshllëk të madh me pasoja serioze dhe afatgjata në të nxënit akademik, social dhe emocional. Situata në vend nuk është e njëjtë për të gjitha grup moshat apo kategoritë sociale. Të mësuarit në distancë ishte një metodë plotësisht e re si për stafin akademik ashtu dhe për nxënësit, prindërit të cilët u ndeshën me shumë sfida që nga mungesa e pajisjeve, mungesa e internetit. Këto elemente çuan në krijimin e boshllëqeve akademike, në veçanti tek grup moshat e fëmijëve të familjeve me deficienca ekonomike. Për të marrë më shumë informacion dhe dhuruar shiko [këtu](#)

# INICIATIVAT



## Fushata “Kovat Blu” – Kujdes dhe Mbrojtje për të Moshuarit

Të kujdesesh për ata që dikur janë përkujdesur për ne, është një nga nderimet më të larta. Kontribuo për kauzën e “Dorcas Aid International” Albania, që jo vetëm të plotësojmë nevojat bazë për të moshuarit e vetmuar, por t’u qëndrojmë pranë dhe t’u sigurojmë mbështetje njerëzore dhe sociale. Dorcas Aid International Albania nëpërmjet fushatës “Kovat Blu” do të sigurojë ndihmë materiale për 370 të moshuar në zona rurale dhe urbane që jetojnë në kushte të vështira, pa mbështetje, të vetmuar e të braktisur, por mbi të gjitha, do të mundësojë përfshirje sociale dhe prekje njerëzore, të cilën nuk e kanë. Për të marrë më shumë informacion dhe dhuruar shiko [këtu](#)



## Mobilimi dhe rehabilitimi i laboratorit të informatikës të shkollës 9-vjeçare Hasan Prishtina

Ky projekt ka për qëllim mbledhjen e fondeve për të rehabilituar laboratorin e informatikës që përfshin mobilimin e saj me 15 tavolina nxënësish, 15 karrige, 3 rafta, 1 projektor si edhe pajisjen me 10 kompjutera të rinj të cilët përmirësojnë ndjeshëm mësimdhënien në fushën e IT-së. Shkolla 9-vjeçare “Hasan Prishtina” ndodhet në Rrugën “Qemal Stafa” në Njësinë Administrative Nr.3, Tiranë hapësirat akademike të së cilës kompozohen rreth një atriumi qendror, i cili shërben dhe si oborr i jashtëm. Pjesë e ambienteve të shkollës është dhe laboratorit i informatikës i cili nuk plotëson kushtet optimale për një hapësirë të tillë akademike. Për të marrë më shumë informacion dhe dhuruar shiko [këtu](#)

**PHI  
LAN  
THRO  
PY  
WEEK**



**make  
it the  
way to...**

**#bringChange**

23

J A V A E  
F I L A N T R O P I S Ë  
2 0 2 1

8 - 1 2 N Ë N T O R 2 0 2 1

Më 8 -12 nëntor 2021, Partnerët Shqipëri organizoi për të dytin vit radhazi eventin “**Java e Filantropisë**”. Ky aktivitet që po kthehet në traditë, synon nxitjen dhe zhvillimin e aktivitetit filantropik në vend duke vlerësuar rëndësinë që ai mbart për avancimin e shoqërisë.

Si pjesë e Javës së Filantropisë 2021 u organizuan aktivitetet:



# J A V A E

## QUIZ



*Z. Hallulli*

Z. Hallulli ka dhënë kontributin e tij të çmuar dhënë gjatë viteve 1914 - 1927 në mbështetje të individëve dhe familjeve tiranase në nevojë, zhvillimin e arsimit dhe ngritjes së shtëpisë së parë për fëmijët jetimë në Shqipëri "Streha Vorfnore".

## Pionierët e Filantropisë

Kjo fushatë kontribuoi në rritjen e informimit publik mbi figura të shquara shqiptare në këtë drejtim si dhe në rritjen e mirënjohjes publike për individë të cilët nuk jetojnë, por që kanë dhënë një kontribut të vyer për zhvillimin e edukimit, shëndetësisë, sportit, e në fusha të tjera. Përmes një kuizi të organizuar në median online, Partnerët Shqipëri promovoi dy figura të shquara si z. Zyber Hallulli, dhe familjen Baholli.



*Q. Baholli*

Familja Baholli ka dhënë kontribut të shquar gjatë viteve 1925 - 1935 në mbështetje të zhvillimit ekonomik të qytetit të Elbasanit, dhe promovimit të edukimit të të rinjve dhe të rejave të qytetit nëpërmjet ndërtimit të bibliotekës "Qemal Baholli".

# FILANTROPISË



## 2 Leksion i hapur me studentë të gazetarisë pranë Universitetit të Tiranës

Një leksion i hapur u organizua me studentët e vitit të parë të degës së gazetarisë dhe komunikimit, në Fakultetin e Historisë dhe i Filologjisë, të Universitetit të Tiranës.

Tema e leksionit ishte: **“Zhvillimi i aktivitetit filantropik dhe infrastruktura mbështëse në Shqipëri”**. Të rinjtë u njohën me disa nga nismat filantropike, si dhe platforma të ngritura për të mbështetur dhurimet ndaj komuniteteve në nevojë. Pavarësisht se ishte një temë e re për studentët, ata shfaqën shumë interes me pyetje dhe shprehën mendimet e tyre lidhur me gjetjen e të dhënave, rëndësinë që ka sektori fitimprurës ndaj mbështetjes së këtij aktiviteti, dhe vlerat që mbart ky aktivitet për zhvillimin e komuniteteve.

# J A V A E



## 3 Konkurs me gjimnazistë

Angazhimi i të rinjve në aktivitete filantropike shihet si një mundësi përmes së cilës të rinjtë zhvillojnë njohuri, dhe marrin pjesë në aktivitete vullnetare në shërbim të komuniteteve.

Gjithashtu, filantropia njihet si praktimi i aseteve të tilla si: njohuri, pasion dhe mirëqenie për të sjellë një ndryshim konstruktiv dhe të qëndrueshëm. Në Shqipëri aktiviteti filantropik ka marrë forma të ndryshme duke u ndikuar nga nevojat e shoqërisë. Si një nismë private e individëve, familjeve dhe kompanive të biznesit që kanë mjetet, kohën dhe dëshirën e motivimin për të mbështetur një nevojë apo adresojnë një çështje në komunitet, filantropia kontribuon në arritjen e një të mire publike. Qëllimi i këtij konkursi ishte të rrisë ndërgjegjësimin dhe të nxisë mendimin kritik të të rinjve, profesionistë të ardhshëm, mbi kushtet e zhvillimit dhe ndikimit të aktivitetit filantropik në të mirë të shoqërisë.

# FILANTROPI SË



Përmes fotove, videove dhe eseve, të rinjtë treguan ndërgjegjësimin e tyre social, kreativitetin nëpërmjet punimeve të paraqitura të cilat ishin befasuese dhe inspiruese.

Në përfundim të konkursit fitues u shpallën:

- Fitues për kategorinë **"Video për filantropinë"**  
**Arbri Metaj**, nxënës i shkollës së mesme "Dervish Hekali", Ballsh.
- Fitues për kategorinë **"Eseja për filantropinë"**  
**Ledjona Rripi**, nxënëse e shkollës së mesme "Kristaq Capo", Berat.  
**Erjon Mejdani**, nxënës i Fshatrave të Fëmijëve "SOS".

# J A V A E



## 4 Fushata "Ndaj një vepër të mirë"

Nisma promovoi raste të aktivitetit filantropik të ndërmarra nga individë, dhe aktorë të shoqërisë civile për t'u ardhur në ndihmë individëve dhe komuniteteve në nevojë. Këtë vit fokusi ishte në kontributin e dhënë nga diaspora.

# FILANTROPI SË



## 5 Intervistë në Radio Tirana, emisioni "Të rinjtë për të rinjtë"

Zj. Kostandina Këruti, Manaxhere Programi pranë Partnerëve Shqipëri, mori pjesë në emisionin "Të rinjtë për të rinjtë", tek Radio Tirana për të diskutuar mbi aktivitetet e organizuara në javën e filantropisë.

*"Java e filantropisë po kthehet një medium diskutimi publik midis grupeve të ndryshme të interesit. E veçanta e këtij viti është përfshirja e të rinjve gjimnazistë, nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, të cilët kanë shprehur mendimin e tyre mbi këtë çështje përmes punëve krijuese."*

Për më shumë ndiqni linkun <https://bit.ly/3HLWQtk>

30

F O N D A C I O N E T  
K O M U N I T A R E


FON  
DAKOMUNITARE  
CIONET

# FONDACIONET KOMUNITARE

## Takime me grupe informale dhe organizata jofitimprurëse mbi fondacionet komunitare

Gjatë muajve nëntor - dhjetor 2021 u organizuan takime me grupe informale dhe organizata jofitimprurëse të cilat kanë shprehur vullnetin e tyre për të operuar si **Fondacione Komunitare**.

Qëllimi i këtyre takimeve ishte diskutimi mbi fondacionet komunitare si dhe identifikimi i nevojave të tyre për të fuqizuar dhe ngritur kapacitetet për të funksionuar si të tilla. **Manaxhimi i bordit, angazhimi dhe mobilizimi i komunitetit, planifikimi strategjik, qeverisja me pjesëmarrje, ngritja e fondeve dhe buxhetimi** ishin disa nga temat mbi të cilat pjesëmarrësit shprehen interes për të thelluar njohuritë e zhvilluar aftësitë. Për grupet informale, marrja e konsulencës ligjore për procesin e regjistrimit si fondacion komunitar, u identifikua si nevojë për asistencë. Mentorimi i aktorëve të lartpërmendur do të vijojë në muajt në vazhdim.





# Artikull informues mbi fondacionet komunitare

## Çfarë janë fondacionet komunitare?

Nuk ka një përkufizim të pranuar nga të gjithë mbi fondacionet komunitare. Fondacionet Komunitare variojnë në varësi të strukturave dhe çështjeve që trajtojnë.

Fondacionet Komunitare janë organizata jofitimprurëse të pavarura, të cilat punojnë në një zonë të caktuar gjeografike. Ato sigurojnë shërbime për komunitetin dhe donatorët e tyre, burime financiare/grante dhe ndërmarrin aktivitete udhëheqëse për të adresuar larmishmërinë e nevojave të komunitetit ku shërbejnë. Një fondacion komunitar është një "mjet" për donatorët lokalë, të cilët dëshirojnë të kontribuojnë me para, asete dhe donacione të tjera për të krijuar fonde të përhershme për të përfituar komuniteti në vazhdimësi. Duke përdorur këto dhurime, një fondacion komunitar bën dhe ndërton kapacitete brenda komunitetit ku vepron për të adresuar nevojat dhe mundësitë lokale. (WINGS, 2010).

Filantropia në komunitet ka origjinën e saj në praktikën e gjata të shkëmbimit, ndihmës së ndërsjellë, solidaritetit dhe zhvillimit të komunitetit. *"Komunitete/grupe lokale që ndihmojnë njëri-tjetrin duke shpërndarë burime për të mirën e përbashkët"*, është një praktikë që ndodh rëndom në kultura dhe komunitete të ndryshme (Kilmurray, 2015).

Fondacionet në komunitet janë njëkohësisht një formë dhe forcë për zhvillimin lokal që përforcon aftësinë dhe zërin e komunitetit, ndërton besim dhe më e rëndësishmja, kontribuon dhe ndërton burimet lokale, të cilat bashkohen për të ndërtuar dhe mbështetur një komunitet më të fortë (Hodgson, 2016) (Wilkinson-Maposa, 2018)

## ***Po cilat janë karakteristikat e fondacioneve komunitare?***

Fondacionet komunitare tradicionale kanë disa karakteristika dalluese. Ato formohen nga traditat lokale, historia dhe kultura për të përmbushur nevojat e zonave të tyre lokale. Disa nga karakteristikat e tyre prezantohen si më poshtë:

- 01** Fondacionet komunitare përpiqen të përmirësojnë cilësinë e jetës të një komuniteti të caktuar;
- 02** Janë të pavarur nga kontrolli ose ndikimi nga organizata, qeveria ose donatorë të tjerë;
- 03** Drejtohen nga një bord qytetarësh që reflektojnë gjerësisht qëndrimet për komunitetet ku shërbejnë;
- 04** Ofrojnë grante për grupe të tjera informale/jofitimprurëse për të adresuar një larmi të gjerë të nevojave që shfaqen dhe ndryshojnë në komunitet;
- 05** Fondacionet komunitare me kalimin e kohës kërkojnë të ndërtojnë, një fond prej dhurime të pa kushtëzuara nga një gamë e gjerë donatorësh, përfshirë qytetarë vendas, organizata jofitimprurëse dhe biznese të tjera;
- 06** Sigurojnë shërbime të përshtatura sipas interesave dhe kapacitetit dhurues të donatorëve;
- 07** Fondacionet komunitare ndihmojnë donatorët të arrijnë qëllimet e tyre;
- 08** Angazhohen në një sërë aktivitesh drejtimi dhe partneriteti të komunitetit, duke shërbyer si katalizatorë, bashkëpunëtorë dhe lehtësues për të zgjidhur problemet dhe për të zhvilluar zgjidhje për çështje të rëndësishme të komunitetit;
- 09** Kanë politika dhe praktika të hapura dhe transparente për të gjitha aspektet e funksionimit të tyre; dhe
- 10** I përgjigjen komunitetit duke informuar rregullisht publikun e gjerë për qëllimet, aktivitetet dhe statusin e tyre financiar.

## ***Kush është "Donatori" për një fondacion komunitar?***

Kur shumica prej nesh mendojnë fjalën "donator", priremi të mendojmë për institucione si fondacione, agjencitë e ndihmës bilaterale, etj. Fondacionet komunitare ofrojnë një karakterizim më të zgjeruar dhe ngjyruës të fjalës, e cila thekson përzierjen e qëllimshme të burimeve nga tre lloje të ndryshme të "donatorëve". Këta janë donatori i jashtëm, vetë fondacioni komunitar dhe njerëzit që bëjnë pjesë në komunitet.

Donatorë të jashtëm janë fondacionet, donatorë bilateral dhe agjenci të tjera zhvillimi të cilat nuk janë të bazuara në komunitet ose janë një hap larg komunitetit ose kontekstit në të cilin ata financojnë. Duke punuar nga distanca këta donatorë kanë nevojë për partnerë me aftësi menaxhuese për fondet e tyre që mund të përmbushin kërkesat e nevojshme institucionale për raportim, matje dhe përgjegjësi. Në këtë mënyrë, donatorët e jashtëm jo vetëm që janë mbështetës financiarë por shërbejnë dhe si një mekanizëm për nxitjen e krijimit të fondacioneve komunitare dhe zhvendosjes së fuqisë së tyre në komunitetet lokale.

Në fondacionet komunitare çdokush mund të jetë një dhurues, dhe nuk po flasim vetëm për ata të cilët kanë burime financiare. Në kontekstin e financimit për zhvillimin e komunitetit lokal dhe ndryshimet shoqërore, kontributet individuale nga "njerëzit e thjeshtë" mund të jenë një faktor i rëndësishëm ndryshues. Individët gjithashtu mund të kontribuojnë në mbështetjen e punës së fondacioneve komunitare përmes dhurimeve të kushtëzuara.

## ***Çfarë kuptojmë me dhurime të kushtëzuara?***

Dhurim i kushtëzuar është një burim i përhershëm që përdoret nga fondacionet komunitare dhe përshtatet me rrethanat që ndryshojnë. Shumë fonde përbërëse të dhurimeve të pakushtëzuara vijnë nga dhuratat e pasurive të marra pas vdekjes së donatorëve që kanë krijuar marrëveshje fondesh me fondacionin gjatë jetës së tyre. Paratë investohen në grupin e investimeve të dhe, në varësi të mënyrës së strukturimit të marrëveshjes, grantet jepen për një periudhë të gjatë ose për një periudhë të specifikuar në marrëveshjen e lidhur mes palëve.

## ***Por kush është "Komuniteti" në Fondacionet Komunitare?***

"Komuniteti" përcaktohet më së shumti nga gjeografia, por ai gjithashtu mund të përcaktohet nga identiteti, interesat dhe vlerat e përbashkëta, veçanërisht tani me zgjerimin e grupeve të mediave sociale që lejojnë njerëzit të mblidhen dhe mobilizohen në mënyrë elektronike.

Komuniteti gjithashtu mund të jetë një zinxhir i lidhjeve midis njerëzve dhe një zhvendosje nga individ i kolektiv. Ai ka një funksion të dyfishtë, atë "bashkues" përmes një ndjenje të përbashkët të përkatësisë dhe sigurimit të një "motori" që mund t'i lejojë kolektivit të shprehë zë dhe të veprojë në lidhje me të tjerët. Me fjalë të tjera, komunitetet krijojnë hapësira për njerëzit të shoqërohen, si dhe të organizojnë, artikulojnë dhe mbrojnë të drejtat e tyre.

F U S H A T A

N Ë N D I H M Ë T Ë  
P E R S O N A V E N Ë  
N E V O J Ë

# Fushata

disa nga fushatat e ngritura gjatë muajve korrik - dhjetor 2021

## #1

Biznesmeni dhe filantropi nga Tetova, Satki Gafuri ka përfunduar ndërtimin e njëres nga shtëpitë, që janë në projekt realizimi në qytetin e Krujës. Ai thotë: “Përbushem shpirtërisht kur e di që një familje në nevojë realizon kushtet njëjtë si të një familjeje evropiane, duke filluar nga mungesa e ushqimit në mjete teknologjike, kjo për mua është arritje e madhe, gjithçka e bëj vetëm për të përbushur misionin tek Zoti”

Për më shumë informacion vizitoni linkun: <https://bit.ly/3BeGYNr>

SHTËPIA



## #2

Studentët bëhen bashkë në ndihmë për të moshuarit.

Studentë të degës së Menaxhim Biznesit, në kuadër të praktikës mësimore, mblodhën fonde falë dhurimeve në mbështetje të shtëpisë së të moshuarve “Strehë & Shpresë”.

Për më shumë informacion vizitoni linkun: <https://bit.ly/3BgrbxZ>

STREHË & SHPRESË





Philea

Philanthropy  
Europe  
Association

ZHVILLIME

NË

EVROPË

## Krijohet Shoqata Filantropike Evropiane - "Philea".

Më datë 7 dhjetor 2021 u shpall "Shoqata Filantropike Evropiane - Philea". Philea synon të krijojë një ekosistem të larmishëm dhe gjithëpërfshirës fondacionesh, organizatash dhe rrjetesh filantropike në mbi 30 vende që punojnë në këtë drejtim.

Ajo u krijua nga bashkimi i dy shoqatave më të rëndësishme evropiane, **European Foundation Centre (EFC)** dhe **Donors and Foundations Networks in Europe (Dafne)** për të patur një zë të përbashkët për filantropinë.

Për më tepër informacion ju lutem lexoni në këtë link: <https://philea.eu/>







Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate, kati 10,  
App. 71 / 73, PO BOX 2418/1  
1010 Tirana, Albania